

## Hyrje

*Antropologji* do të jetë emri i revistës shkencore të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit. Kjo revistë hap një cikël të ri të botimeve shkencore të Institutit, duke zëvendësuar revistën *Kultura Popullore*. Kjo ka ardhur për nevojën e pasjes së një shënjuesi më të qartë për natyrën dhe objektin e dijes që do të paraqesë: një revistë për antropologjinë social-kulturore. Sigurisht, kërkimi antropologjik do të ketë në fokus edhe kulturën popullore, por jo vetëm. Në fokus do ketë gjithë kulturën dhe kulturoren.

Antropologjia, etnologjia apo folkloristika nuk janë të vetmet disiplina që merren me studimin e kulturës popullore dhe kulturës në tërësi (Kuper 2001). Por, kultura ka qenë zbulimi kryesor i antropologjisë social-kulturore. Sigurisht, problemi nuk mbyllet lehtë as me termin kulturë, as me termin antropologji. Por, përtej dyshimeve, kritikave e përpjekjeve për të tejkaluar kulturën si koncept autoritar apo totalitar, ajo që ka rëndësi specifike në zhvillimin e identitetit të antropologjisë social-kulturore është njohja dhe qëmtimi i saj. Shohim se kultura shndërrohet në nocionin bazë të diskurseve politike që, për hir të së vërtetës, pavarësisht emrave të rinj të përdorur në vend të kulturës, vënë përballë vizionin iluminist përkundrejt përgjigjes së ardhur prej romantikëve. Kësisoj, nocioni i kulturës është ndër më politikët dhe për rrjedhojë, është tejet e vështirë të gjesh një dije që implikohet në detyrimin për të qenë e angazhuar në rrjedhat e jetës njerëzore më shumë se sa antropologjia social-kulturore. Ja pse mendojmë se antropologjia social-kulturore ka kontribuar dhe mund të kontribuojë në studimin e kulturës më shumë se asgjë tjetër. (Kuper 2000).

Duke perifrazuar Dante Alighieri-n, Frank Kermode shprehet se koha që jetojmë ka një veçori: është një e tashme në të cilën janë plandosur të gjitha kohërat (1967, 6). Një situatë ku të gjithë kohërat janë të pranishme është situata ideale për studimet antropologjike. Ndoshta nuk është aspak e tepërt të shënohet që në krye të herës se një nga objektivat kryesore të debatit antropologjik, qoftë ai i shtrirë në qasje historike, qoftë ai që në themel merr kërkimin klasik etnografik, do të duhej të kishte si qëllim studimin e produktit social të të jetuarit në kohën e rutinizmit të së jashtëzakonshmes. Shto këtu edhe faktin se antropologjia social-kulturore nuk e ka aspak të huaj përvojën në studimin e situatave të jashtëzakonshme. Të tilla gjendje të jashtëzakonshme do të ishin: lindja e shteteve dhe shoqërive moderne, shekullarizimi i mendimit,

kohës dhe hapësirës, kolonializmi, nacionalizmi, racizmi, socializmi, apo përballja me zhvillimet e jashtëzakonshme teknologjike. Sigurisht, rreziku është që nëpërmjet pranimit të së jashtëzakonshmes si të zakonshme, qoftë nga lentet e teorisë antropologjike, qoftë nga ajo e njerëzve që studiohen, të pezullohet vetë domethënia e së jashtëzakonshmes, por le ta marrim këtë si një sfidë me të cilën do duhet të përballen studiuesit, duke shpresuar në këtë kuadër, që kjo revistë të kthehet në një truall ku të zhvillohet debati teorik mbi aspekte të tilla të trajtuara në kuadër të studimit të kulturës dhe shoqërisë shqiptare e hulumtuar në gjithë trajtat dhe gjendjet e saj.

Antropologjia me fokus analizën e kulturës dhe shoqërisë shqiptare, qoftë ajo e realizuar nga shqiptarët për shqiptarët, qoftë ajo nga studiues jo shqiptarë që janë marrë me shqiptarët, ka pësuar ndryshime të shumta në periudhën post-diktatoriale. Etnologjia dhe folkloristika shqiptare e kaluan pragun e socializmit, duke ruajtur të gjithë hipotezat dhe mëtimet teorike aplikuar gjatë socializmit, por me disa ndryshime në reduktimin e gjuhës emancipuese, si dhe duke riartikulluar një qëndrim që do ta quanim *albanologjik*. Artikulimi albanologjik nuk bëhet duke braktisur krejt trashëgiminë dhe as duke përvetësuar në mënyrë solide dijen albanologjike të para-komunizmit (pak vend zënë shqyrtimet kritike të kësaj albanologjie). Albanologjizimi i etnologjisë, folklorit, madje dhe studimeve të artit bëhet me qëllim për t'i dhënë një rol të ri këtyre fushave të mendimit në periudhën post-socialiste. Ky albanologjizim është pjesë e shumë flukseve me natyrë konservatore apo restitutive që hodhën shtat në periudhën post-socialiste. Secili autor ka një dimension personal të këtij rrugëtimi.

Këtë lëvizje drejt albanologjizimit e ndihmojnë dy faktorë kryesorë. Së pari, vetë trendi konservator që kishte përfshirë atmosferën intelektuale në shumë drejtime, por njëkohësisht edhe fakti që në vitet '80 e gjithë gjuha etnologjike dhe folkloristike i ishte nënshtruar formateve etnonacionaliste, formate që erdhën për shkak se socializmi shtetëror kishte mbetur pa aleat ndërkombëtar, duke iu kthyer aleancës me etnonacionalizmin. Pavarësisht ndryshimeve të ndodhura, dukej qartë se etnologjia dhe folkloristika shqiptare nuk ishin fort të përgatitura për t'u përballur me krizat në periudhën post-socialiste, ndoshta edhe për shkak se asnjëra prej tyre, edhe nëse kishte dijeni (gjë fort e vështirë duke marrë parasysh izolimin) nuk kishte arritur të kuptonte "krizat" që kishin kaluar dhe po kalonin ndërkohë etnologjia dhe folkloristika ndërkombëtare.

Sidoqoftë, pas rënies së komunizmit, një numër i konsiderueshëm studiuesish erdhën nga universitete e qendra të ndryshme kërkimore nga jashtë dhe morën në shqyrtim tema të ndryshme antropologjike, duke e bërë kërkimin antropologjik ndër dhe për shqiptarët më të pasur me nderdhënie dhe dialog.

### **Antropologjia brenda dhe jashtë shtëpisë tënde**

Nevoja për të debatuar për raportin në mes studimit antropologjik brenda dhe jashtë shtëpisë është sa një kurth, aq dhe një nevojë për zhvillimin e mendimit kritik në antropologjinë social-kulturore. Rëndësia për ta parashtruar sërish këtë debat në këtë numër të parë të revistës *Antropologjia* bëhet për disa arsye. Më së pari, shoqëria shqiptare gjatë gjysmës së dytë e shekullit XX ka qenë shoqëria më e izoluar dhe më e kontrolluara nga shteti gjatë komunizmit. Mbyllja e saj nuk mbaroi bashkë me komunizmin. Kujtojmë se shqiptarët e Shqipërisë vetëm pas vitit 2010 patën mundësinë të lëvizin pa viza, sigurisht, në një format të kufizuar në një afat 3 mujor. Kjo mundësi është vetëm për të qenë konsumator apo vizitor, por ndërkohë nuk jepet e drejta e punës, apo e arsimimit pa një aplikim specifik. Në krahun tjetër, Kosova është vendi i fundit në gjithë Europën Juglindore, banorët e së cilës nuk kanë të drejtë të udhëtojnë jashtë pa vizë. Pra, me pak fjalë, duke u kthyer te çështja e ndarjes së studiuesve vendas dhe të huaj, te vetja dhe tjetri, nuk kemi mundësi të anashkalojmë dinamikat ekzistente të përjashtimit që përjeton njeriu shqiptar.

Së dyti, bashkëbisedimi antropologjik mbi raportin studiues/i studiuar bëhet i domosdoshëm pasi edhe nëse studiuesi nuk deshiron të klasifikohet si vendas apo i huaj, kjo ndodh nga vetë njerëzit kur ushtron kërkimin në terren. Kujtojmë se, etnologjia dhe folkloristika shqiptare nuk janë ekspozuar ndaj këtij debati zhvilluar me një intensitet shumë të lartë kryesisht gjatë viteve '80 të shekullit XX. Në këtë kohë, etnologjia dhe folkloristika shqiptare ishin më të izoluar dhe intensifikonin një lloj etno-nacionalizmi socialist. Së treti, "shtëpia" si metaforë nuk do të duhej kufizuar vetëm në ato përcaktime tashmë të trajtuara jo pak në historinë e mendimit antropologjik, por edhe duke pasur parasysh "shtëpitë" e krijuara nga disiplinat kërkimore brenda dhe jashtë Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit. Ky vetëdijësim për rëndësinë e raportit në mes studiuesit dhe të studiuarit bëhet akoma më i qartë në situatën ku ngjarjet dhe kohërat në të cilat antropologjia ushtrohet, nuk janë një gjendje e zakonshme. Reflektimi i studiuesit bëhet i domosdoshëm, jo thjesht se kush po studion apo studiohet, apo për të tejkaluar një raport të

klasifikimit të tjetrit, por dhe për *kë* po e shkruajmë tekstin. Tema se për *kë* shkruhet teksti antropologjik, nuk do të duhej reduktuar në qëllimet pragmatike të antropologjisë, por analiza do të duhej shtrirë në çdo por të epistemës dhe etikës. Dhe, nëse jemi në kushtin kur po ushtrojmë kërkimin antropologjik në një gjendje sociale e kulturore krejt të trazuar moralisht e politikisht, duke ecur me provokimin e të jetuarit të një kohe me të gjitha kohërat brenda, atëherë kjo pyetje bëhet edhe më e rëndësishme.

A mjafton ndarja bazuar në raportin studiues/të studiuar brenda dhe jashtë shoqërisë tënde? Një territor antropologjik që mund të na shfaqet në shumë dimensione, është pikërisht ai në mes shtëpisë tënde dhe botës atje larg. Për këtë, Chris Hann ka riartikulluar disa dimensione të antropologjisë *in between* (Hann 2008-2009: 40-50). Një antropologji e gjinisë *in between*, merr në sy territore gjeografike të stërmëdha, si Euroazia, por edhe territore simbolike e historike, p.sh., ajo në mes kozmologjive të ndryshme apo ajo në mes periudhave të ndryshme historike. Konkretisht, ajo në mes kozmologjisë etnologjike praktikuar gjatë diktaturës komuniste dhe asaj pas rënies së saj. Etnologjia e albanologjizuar mund të shihet si një kthim tek një traditë, apo një kalim drejt një përpjekjeje të re, pra është një gjendje e ndërmjetme. Edhe antropologjia kritike e zhvilluar në shoqëri të vogla e me një traditë të vogël si ajo shqiptare, gjendet në kushtin *in between* të traditës e debateve lokale dhe atyre të sjella nga debati në antropologjinë ndërkombëtare.

Parë e riparë në lentet e antropologjisë kritike, mundet që i gjithë moderniteti, me të gjitha format e praktikat e tij, të shihet si një formë kalimtare. Është hedhur dhe teza e një tranzicioni permanent, një ftesë teorike kjo me mjaft sfida e pikëpyetje. Bjorn Thommsen (2014), fjala vjen, e sheh modernitetin si gjendje kalimtare e cila nuk ka një fund dhe pikërisht prej këtu komenton se një individ që rri gjithmonë në rite *de passage* marroset dhe një shoqëri e tillë çmendet. Shtrimi i këtyre pyetjeve që vijnë nga kjo gjini antropologjike që e sheh veten pjesë të një gjendjeje *in between* dhe njëherazi shtrimi i pyetjeve për efektet sociale që sjell të jetuarit në këtë kusht, do të sillte shumë kontribute në dijen antropologjike.

### **Kultura, ndryshimi, e jashtëzakonshmja**

Është krejt njerëzore inventimi i vazhdueshëm i kulturës dhe rikapja e kuptimeve tashmë të formësuara prej kohësh. Antropologjia është gjendur gjithmonë në mes sfidës për ta ekzotizuar familjaren dhe për të familjarizuar

ekzotiken. E, po ashtu, është gjendur dhe përballë sfidës për të normalizuar të jashtëzakonshmen dhe për ta jashtëzakonizuar normalen. Porse, pa dashur aspak të shpallet një gjendje post-njeri e, aq më pak, apokaliptike, na duhet përsëri të rimarrim konceptin e gjendjes së jashtëzakonshme dhe të nënvizojmë ndjesinë se antropologjia e kohës së sotme gjendet para disa ndryshimeve social-kulturore, të cilat nuk duken që kanë një referencë diku, në mënyrë që të quhet e zakonshme. Ndryshimet në formën e qeverimit, krizat politike të shoqëruara me çmagjepsje ndaj shtetit, demokracisë, ndryshimet në teknologji, sidomos në botën virtuale, ndryshimet në *soundscape*-in, në intensitetin e shpejtësinë e lëvizjes së ideve, zërave e njerëzve, sendeve e gjithçka që na rrethon, duket se ka prekur deri në themel socialen dhe kulturoren. Ende nuk i dimë efektet e kësaj bote në plotësi, porse dimë që jemi në një periudhë si shoqëri njerëzore, ku i gjithë raporti njerëzor e shqisor është ekspozuar ndaj një intensiteti të vullshëm ndikimesh e, për rrjedhojë, njeriut i duhet të negociojë e të krijojë hapësirën e pjesëmarrjes dhe vetë kulturën, sferën e kuptimeve dhe praktikën e tyre.

Në historinë e debatit mbi ndryshimet kulturore dhe vetë kuptimin e ndryshimit dhe vazhdimësinë kulturore, studiuesit e kulturës janë luhatur në mes idesë se kultura njerëzore ndryshon shumë pak me kalimin e kohës. Te disa autorë mbizotëron ideja se kulturat ndryshojnë vazhdimisht, sepse njerëzit e kanë këtë aftësi. Te disa autorë të tjerë, konflikti social shihet si diçka që përbënte të jashtëzakonshmen, duke nënkuptuar rendin si normalitet. Të tjerë akoma e vendosën theksin te konflikti, e më vonë, te vetë kaosi si natyrë e brendshme e kulturës dhe rendit social. Kjo ka bërë të kemi themelime të shumë teorive që kanë në boshtin e tyre ndryshimet aksiale apo themelore dhe atyre që i japin peshë ndryshimit të çdo aspekti kulturor. Cilindo shteg që të ndjekim, ajo çfarë po ndodh sot me shoqërinë njerëzore dhe atë shqiptare, duket të jetë e pazakontë. Për këtë, një ndër ftesat me vend në lëmin e antropologjisë është ajo e ardhur nga Eriksen, e cila e vë theksin te shpejtësia e ndryshimeve, e lëvizjeve, e komunikimit (Eriksen 2016).

Për të ilustruar shpejtësinë e ndryshimit, po marr zonën e verilindjes. Para 15 vitesh, kohë kur kisha intensifikuar kërkimin në terren në Has, kishte ndodhur një ndryshim themelor. Ishte hapur kufiri me Kosovën, por rrugët automobilistike ishin tejet të amortizuara. Asokohe, vetëm pak tregtarë kishin telefona nëpër duar. Ende nuk dihej që do të kishte smartphone dhe pakkush ishte në gjendje të besonte se ato do të bëheshin pjesë e pandashme e jetës së

përditëshme edhe për banorët e kësaj zone. Sot, Verilindja e Shqipërisë është e mbushur me smartphone, me rrjete interneti, rrugët automobilistike janë shtruar në pjesën dërrmuese, por, ndërkohë, rinia vijon të ikë jashtë shtetit. Duke iu rikthyer kërkimit të mëparshëm në zonën kufitare Shqipëri-Kosovë, në atë kotë mendoja se, nëse këto zona do të vijonin të ishin një vend i ikjes, atëherë dhe tradita do të kishte kushte konkrete të riartikulohej, por tendenca do të ishte vijimi i konservatorizmit. Kjo tezë, ndoshta, qëndron ende për sistemin e pronësisë mbi tokën që ishte dhe fokusi kryesor i kërkimit të atëhershëm, por nuk jam më i sigurt nëse qëndron lidhur me sistemin martesor. Përdorimi intensiv i teknologjisë elektronike, sidomos ai i rrjeteve sociale, si facebook ka sjellë që marrëdhëniet martesore të ndryshojnë jashtëzakonisht shumë. Pra, nëse fshati ishte ekzogam dhe distanca sociale që të rinjtë përshkruanin e kufizonte mundësinë e tyre që të njihnin një partner, sot sistemi i ofruar nga komunikimi online e ka tejkaluar sistemin e kontrollit vendosur nga e drejta kanunore. E kjo, jo vetëm për sistemin martesor, por dhe për krijimin e dëshirës, shijeve estetike, muzikore, kulturës ligjore e politike në tërësi. Me pak fjalë, pa hyrë tek analiza e krijimit të komuniteteve transnacionale krijuar nga emigracioni, komunitetet, rrjetet, miqësitë e krijuara nga rrjetet sociale, jo vetëm që janë një realitet social që s'mund të shmangen nga njeriu në jetën e përditshme, por ato bëjnë që të kërkojnë ndryshimin, qoftë të teknikave të kërkimit në terren, por dhe tek objekti kërkimor në lëmin antropologjik.

### **Premisat dhe nevoja për një antropologji kritike**

Brenda dhe jashtë Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit janë krijuar kushtet për pasurimin e një trajktoreje studimesh antropologjike reflektive. Kjo lloj antropologjie e ka zhvendosur shqetësimin e kërkimeve antropologjike prej kulturës popullore drejt kulturës dhe shoqërisë. Si e tillë, ajo e ka kapacitetin për të përfshirë brenda vetvetes dhe shqetësimet teorike mbi kulturën popullore. Një gjë e tillë ndihmon pasjen e një pamjeje më të plotë të njeriut si autor dhe produkt i kulturës apo kulturave. Ndërkaq, është vërejtur një reagim refuzues ndaj kësaj qasjeje, i cili për fat të keq ka ndodhur jo publikisht, pra nuk ka pasur një debat publik se përse e si duhet të aplikohet dija antropologjike dhe se ku e tek ajo ndryshon me etnologjinë apo folkloristikën. Në atë pak biseda që kemi mundur të zhvillojmë me ata kolegë e dashamirës të kulturës e trashëgimisë kulturore që kanë shprehur këtë refuzim,

konstaton lehtë se mungojnë shumë informacione që do të mund të ndërtonin një komunikim. Referimi i tyre më shumë bazohet te tradita lokale shqiptare. Ndërkohë, kjo e fundit nuk kalon nëpër filtra kritikë dhe në jo pak raste, edhe ajo nuk është e njohur aq mirë nga ana historike.

Antropologjia social-kulturore e pozicionuar si kritike e refleksive është parë si e largët me një traditë të njohur më shumë në publikun shqiptar që në fokus ka studimet për kulturën materiale, folklorin, muzetë e trashëgiminë kulturore. Një gjë e tillë do të duhet të na bëjë të mendojmë me kujdes, sepse ata që janë brenda historisë dhe zhvillimeve të debateve antropologjike e dinë mirë që këto studime e fusha dijeje nuk janë aspak të huaja apo të largëta për antropologjinë kulturore. Kësisoj, lipset një qasje më pragmatike ndaj këtij pozicioni refuzues ndaj mendimit antropologjik dhe, për këtë, mendoj se thellimi i dijeve antropologjike në lëmin empirik etnologjik e albanologjik do të pajiste studiuesin me dijet e domosdoshme për aplikimin e tyre në sferën e trashëgimisë, turizmit, apo sektorë të tjerë ku dija lokale antropologjike mund të aplikohet.

Një tjetër sulm që duket se antropologjia kritike ndeshet çdo ditë, është kushti për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut. Nëse antropologjia social-kulturore në Shqipëri do të vendosej para këtij kushti, atëherë do të kishim fundin e saj dhe mirë do të ishte të kishim një fund, i cili të mos pranonte t'i hynte aspak sfidës së plotësismit të kërkesave të tregut. Ky qëndrim kaq i prerë vjen, sa për faktin se kërkesat e tregut nuk dihen dhe nuk plotësohen asnjëherë dhe, së dyti, se antropologjia nuk ka shqetësime ekonomike, por ka shqetësime sociale e kulturore, të cilat duhet të ruajnë sferën e tyre të autonomisë. Antropologjia social-kulturore nuk do të duhej t'i nënshtrohej asnjë ideologjie mbizotëruese, ndryshe ajo do të përfundonte në një dije mediokre. Rrugëdalja prej këtij kurthi është ndërmarrja e projekteve kërkimore që kanë në fokus kulturën në holisticitetin e saj e po ashtu, duke marrë në fokus temat kryesore që shqetësojnë shoqërinë. Temat kryesore mund të jenë: mënyra e organizmit shoqëror, shteti, ndryshimet në besimet dhe kozmologjinë, raportin me veten dhe tjetrin, raportin me natyrën, aftësitë krijuese e përforcuese. Prej kësaj pikëpamjeje, antropologjia e një vendi si Shqipëria mund të jetë në dialog me shoqërinë për të krijuar një dije, e cila ka qëllimin kryesor grishjen e mendjes drejt njohjes. Kushdo që ruan pozicionin si antropolog, duhet të kërkojë të jetë një dijetar sokratik, që nuk ka shqetësim t'ia bëjë qejfin ndokujt, apo gjësendi, si tregut - me tezat e veta, por që ndjek shtegun e vet drejt njohjes.

### **Bibliografi**

- Herzfeld, Michael. 1987. *Anthropology Through the Looking-Glass: Critical Ethnography in the Margins of Europe*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Hann, Chris. 2009. *Anthropology in between*. Raporti 2008-2009, Vëll I: 40-50. Halle: Max Plank for Social Anthropology.
- Kermode, Frank. 1967. *The Sense of an Ending: Studies in Theory of Fiction*. London: Oxford University Press.
- Kuper, Adam. 2000. *Culture: The Anthropologists' Account*. Harvard University Press.
- Thomassen, Björn. 2014. *Liminality and the Modern: Living Through the In-Between*. Burlington: Ashgate